

Shenjtori i ditës: Omologjet Theofani - Oshënar Grigor Dialogu, Papë i Romës



E premte, 12 mars 2021 – Shenjtori i ditës.

TASHMË DERI PËR PASHKË NUK KONSUMOJMË MISH DHE PRODUKTET E TIJ. (Këtë javë mund të konsumojmë bulmet dhe peshk). KRESHMA E PLOTË FILLON NË DT.15 MARS.

Omologjet Theofani. Oshënar Grigor Dialogu, Papë i Romës. Simeoni, Theologu i Ri.

– Omologjet Theofani –

Theofani, ati ynë oshënar, lindi në vitin 759, gjatë sundimit të perandorit ikonoklast Konstandin Kopronimi (741-775), në një familje fisnike dhe të pasur të Konstandinopojës. Atë e edukoi e ëma, e cila dhe e fejoj kur ishte dymbëdhjetë vjeç, me një trashëgimtare të pasur, që e quanin Megalo. Pas tetë vjet fejesë, ditën e martesës, kur ata ishin vetëm në dhomë, Theofani i tregoi gruas se gjithmonë kishte dëshiruar të përqafoje jetën murgërore, ndaj e bindi edhe atë që të jetonin së bashku si vëlla e motër. Ata u angazhuan në këtë betejë të lavdishme të ruajtjes së virgjërisë në martesë për dy vjet, pavarësisht nga presioni i të atit të Megalos, i

cili arriti të merrte nga perandori Leoni IV (775-780), emërimin e Theofanit si qeveritar i Kizikës, me detyrën për të mbikëqyrur ndërtimin e fortesës, duke shpresuar se kjo përgjegjësi do ta largonte nga aspiratat asketike.

Por rezultati ishte krejt i kundërt; sepse zyrtari i devotshëm e kalonte kohën e lirë duke vizituar asketët e krahinës. Njëri prej tyre, që quhej Grigor, e këshilloi shën Theofanin të vazhdonte të jetonte në këtë mënyrë dhe të këmbëngulte në dëshirën e tij për të mohuar botën. Gjatë një udhëtimi në Konstandinopojë mori titullin spatharios, por asgjë nuk mund t'ia shuante etjen që kishte për Perëndinë. Menjëherë pas vdekjes së perandorit dhe të vjehrrit, me lejen e perandoreshës regjente Irena, pasi liroi skllevërit dhe shpërndau pasurinë e tij të pamasë, e çoi të shoqen në një manastir të arkipelagut të Prinkipëve. Të shoqen nuk e takoi më në këtë jetë, por i shkruante që ta nxiste në detyrat e jetës murgërore. Vetë u bë murg në manastirin e Polikronit, në malin Sigriana, afër Kizikës.

Pastaj kaloi një periudhë të shkurtër në një pronë të familjes, që gjendej në ishullin e Kalonimos (Propont). Rreth tij u mbledhën kandidatë për jetën murgërore, por Theofani refuzoi t'i drejtonte, duke ia besuar drejtimin shpirtëror të vëllazërisë një murgu me përvojë nga një manastir tjetër, ndërsa vetë qëndroi për afro gjashtë vjet si eremit aty pranë. Kur igumeni i manastirit ndërroi jetë, vëllazërit njëzëri i kërkuan atij t'i zinte vendin. Me frikën se mos humbiste qetësinë e shenjtë, shenjtori u kthye në malin Sigriana. Atje mori një tokë që quhej Megalo Agros, ku ngriti një manastir, i cili u bë një nga qendrat më të njohura në atë kohë. I veshur me armatimin e luftëtarëve të Zotit: me kreshmë të matur, që than afshet e mishit, me agripni, që e bën mendjen të kthjellët në mes të natës dhe me lot që pastrojnë zemrën, ishte për të gjithë një ikonë e gjallë e bindjes së përsosur asketike.

Përsëri iu mbledhën nxënës përreth dhe u detyrua të merrte drejtimin e tyre shpirtëror. Dinte si të fliste me njerëzit e thjeshtë, por edhe me njerëzit e arsimuar dhe u mësonte me autoritet, por pa imponim, dogmat e shenjta dhe artin e zotërimit të pasioneve. Për të plotësuar përvojën e tij, ndërmori një udhëtim në manastiret e Bitinisë dhe të Hellespontit. Përveç detyrave dhe shërbimeve shpirtërore si bari, shkroi një Kronografi të gjerë, e cila mbetet ende një nga dokumentet më të mira për njohjen e historisë bizantine. Duke u bërë një enë e zgjedhur e hirit, mirëpriste me dashuri cilindo që vinte aty. Gjatë një zie buke i urdhëroi nxënësit që të shpërndanin të gjitha rezervat e manastirit tek ata që nuk kishin të hanin, por me hirin e Perëndisë gjithçka zëvendësohej sërish.

Në vitin 787, u thirr të merrte pjesë në Sinodin e Dytë të Nikeas, i cili mbrojti nderimin e Ikonave të Shenjta. Ai shkoi në këtë sinod i veshur thjesht si një njeri i varfër, por i çuditi të gjithë të pranishmit me njohjen e thellë të traditës së Etërve

të Shenjtë. Kur u kthye në manastir, u sëmur rëndë nga gurët në veshka, gjë që e detyroi të qëndronte vazhdimisht në shtrat.

Kur perandori jobesimtar Leoni V Armeni rinisi persekutimin kundër ikonave të shenjta, në vitin 815, i paralajmëruar për reputacionin që kishte fituar igumeni i Megalo Agros, e thirri Theofanin në Konstandinopojë, me pretekstin që të lutej në prag të fushatës së tij kundër bullgarëve. Ushtarët që ishin dërguar nga perandori e morën me forcë, pavarësisht nga sëmundja e tij dhe dogjën manastirin. Kur e çuan në Konstandinopojë, Theofani refuzoi të takonte ballë për ballë perandorin heretik. Kjo e shtoi zemërimin e tiranit, i cili urdhëroi që shenjtori të burgosej në manastirin e Sergjit e Bakut, ku patriarku i ardhshëm heretik, Leon Gramariani, u përpoq më kot që ta thyente. Shenjtori i hodhi poshtë me sukses argumentet e tij.

Pas kësaj e mbyllën për dy vjet në një qeli të errët të pallatit të Elefterit. Pas këtyre perandori, pasi pa qëndrueshmërinë e tij në besim, urdhëroi ta internonin në ishullin e Samothrakës. Shenjtori i mbijetoi vetëm tri javë vështirësive të udhëtimit dhe dorëzoi shpirtin e tij në duart e Perëndisë, më 12 mars të viti 817 (ose 818). Varri i tij u bë menjëherë një vend shërimesh për banorët e ishullit të Samothrakës. Në vitin 822 nxënësit e tij shkuan që të merrnin lipsanin dhe ta çonin në manastirin e Megalo Agros. Shën Theodhor Studiti, i cili e admironte shën Theofanin, mbajti me këtë rast një fjalim për nder të tij.

* * * * *

– Oshënar Grigor Dialogu, Papë i Romës –

Ati ynë oshënar, Grigori, lindi në Romë, rreth vitit 540, në një familje të rangut senatorial, e cila kishte nxjerrë disa papë. Pas përfundimit të studimeve në mënyrë të shkëlqyer, u bë prefekt i qytetit të Romës. Por, i prirë që në rini në studimin e librave të shenjtë, mendonte se nuk ishte për atë detyrë, ndaj hoqi dorë pas vdekjes së të atit. Pasurinë e pamasë që i mbeti e shpërndau, duke ua dhënë disa manastireve: gjashtë në Sicili dhe njërit në Romë, i cili u ngrit mbi pallatin e tij dhe iu dedikua apostullit të shenjtë Andrea, ku hyri edhe vetë si murg i thjeshtë. Jetoj në vetëmohim të plotë dhe arriti të bisedonte vazhdimisht e në liri të plotë me Perëndinë dhe të shijonte ëmbëlsinë e soditjes, të cilën e pengojnë shqetësimet e ndryshme në botë. Si pasuri kishte vetëm një tas argjendi, në të cilin merrte ushqimin. Kur njëherë takoi një tregtar, të cilit i ishte mbytur anija dhe kishte përfunduar të kërkonte lëmoshë, Grigori i dhuroi tasin dhe që atëherë ndihej

plotësisht i lirë. Si përgjigje, Perëndia i dha pushtet të kryente mrekulli.

Por nuk arriti të përfitonte për shumë kohë paqen e manastirit. Sapo u ngrit në pontifikat, papa Pelagji II (579-590) e emëroi apokrisar dhe e ngarkoi të shkonte në Konstandinopojë, që të bënte perandorin dhe patriarkun të interesuar për çështjet e Italisë së shtypur nga lombardët. Grigori qëndroi atje për gjashtë vjet, duke u bërë shembull me thjeshtësinë dhe virtytet e tij dhe duke hedhur poshtë gabimet e patriarkut Eftik. Kur u kthye në Romë me lipsane të çmuara, shkoi përsëri në manastirin e tij, ku pas pak u zgjodh igumen. Të gjithë murgjit e donin dhe shenjtori i ndihmonte në të gjitha kërkesat, si shpirtërore dhe ato materiale, me qëllim që t'i ruante nga përkujdesjet e tjera; por dinte të ishte i rreptë dhe të ruante traditat murgërore. Kështu, ai e hodhi në një grumbull mbeturinash trupin e një murgu të vdekur, i cili mbante fshehur tri monedha ari, por pastaj kreu për të Liturgji për tridhjetë ditë rresht dhe mori nga Perëndia faljen për të. Manastiri i Grigorit, falë rreptësisë së tij, u bë një shkollë e vërtetë shenjtërie dhe i gjithë populli e konsideronte igumenin si mbrojtësin e tij.

Një ditë, tek po kalonte në mes të tregut ku shiteshin si skllever fëmijë biondë e të bukur, shën Grigori u prek dhe pyeti se nga vinin këta engjëj të veshur me trup. Mësoi se vinin nga Anglia, tokë që ende nuk e kishte marrë Lajmin e Mirë të Ungjillit. Shenjtori qau dhe nga ai çast vendosi të nisej me mision atje bashkë me disa murgj. Pasi kishin ecur tri ditë në këmbë drejt Veriut, e arritën lajmëtarët e dërguar nga papa, të cilët e njoftuan se populli kishte ngritur krye dhe kërkonte kthimin e tij.

Vitet e mëpasshme shërbeu si sekretar i papa Pelagjit dhe, kur ky i fundit ra viktimë e një epidemie murtaje, në vitin 590, kleri, senati dhe populli e detyruan Grigorin të merrte fronin, pavarësisht nga protestat dhe thirrja që i bëri Mavrikut, perandorit të Konstandinopojës. Fatkeqësisht, murtaja po përhapej kudo dhe shenjtori e nxiti popullin të pendohej dhe të kuptonte se ky ndëshkim vinte nga qielli, për shkak të mëkateve të tyre. Organizoi një procesion të madh nëpër qytet me në krye një ikonë të Hyjlindëses, në të cilin morën pjesë të gjithë murgjit dhe murgeshat. Tregohet se kudo që kalonte ikona e shenjtë, pastrohej ajri i ndotur dhe Kryeengjëlli Mihail, i cili u shfaq me shpatë në dorë mbi kështjellën që sot quhet fortesa e Engjëllit të Shenjtë (Castle Sant'Angelo), e futi atë në mill. Murtaja pushoi menjëherë, por Grigori u largua, që t'u shpëtonte nderimeve. U fsheh në një shpellë, por një shtyllë e ndritshme bëri që ta zbulonin dhe kundër dëshirës e çuan përsëri në Romë, ku u dorëzua papë më 3 shtator 590.

Përgëzimeve iu përgjigjej duke qarë: “Me barrën e episkopit, ja ku jam lidhur me botën më ngushtë se kur isha laik. E humba gëzimin e thellë të qetësisë sime; nga

jashtë është një lartësim, përbrenda një rënie. Kur e përmbushja detyrën e përditshme, përpiqesha të kthehesha brenda vetes dhe nuk mundesha; mundime të zhurmshe dhe të kota më sulmonin”. Kisha ishte në fakt në gjendje të mjeruar, e skllavëruar nga herezitë, skizmat, nga shtypja barbare apo nga trazirat e princave të krishterë. Ndërkohë që në Romë mbretëronte uria, papa organizoi ndarje ushqimesh dhe ndihma për të vobektët. Përditë priste në tryezë 12 të varfër, të cilëve u lante duart dhe e quante veten përgjegjës për ata që vdisnin nga uria. Një ditë, një mysafir i trembëdhjetë u shfaq në tryezën e dashurisë dhe pas pyetjes së papës i zbuloi se ishte engjell i dërguar nga Perëndia për ta ndihmuar deri në fund të këtij shërbimi.

Grigori e organizoi jetën në pallatin pontifikal sipas ikonës së manastirit. Kujdesej për Shërbesat Liturgjike dhe Tipikonë e adhurimit, nxiti nderimin e lipsaneve të shenjta, organizoi litani të shpeshta, caktoi lutjet dhe leximet që duhet të thuheshin gjatë vitit liturgjik dhe reformoi himnimin kishtar. Në të gjitha kishat që vareshin nga Roma, vëzhgoi zgjedhjen e rregullt të episkopëve, shoi simoninë dhe nuk u lejoi episkopëve të qëndronin jashtë dioqezave të tyre. Mblodhi sinode lokale, me qëllim që të luftonin kundër herezive dhe çrregullimeve morale dhe pengoi ndërhyrjen e autoriteteve civile në punët e Kishës, si dhe atë të episkopëve në drejtimin e manastireve. Shqetësimi i tij shtrihej kudo, predikonte në kishat e Romës dhe, kur nuk mundej për shkak të sëmundjeve të shpeshta, hartonte omelinë, të cilin e lexonte një klerik tjetër në vend të tij. Kujdes të veçantë tregonte për korrespondencën e gjerë me të gjithë botën e krishterë, por gjente edhe kohë të shkruante ligjërata shpirtërore.

Papa i shenjtë ishte i përlurur si vetë Ai që tha: “Jam i butë dhe i përlurur” (Math. 11:29). Priftërinjtë i quante vëllezërit e tij dhe laikët zotërinjtë e tij. Në të gjitha letrat përdorte vetëm këtë titull: “Shërbëtor i shërbëtorëve të Perëndisë”, dhe e konsideronte veten me sinqeritet si mëkatarin më të madh. Patriarkut të Konstandinopojës, shën Joanit të IV-t, Kreshmuesit (2 shtator), i cili, në veprat e tij kishte përdorur titullin Patriark Ekumenik, shën Grigori i bëri vërejtje me kujdes, duke i kujtuar se asnjë episkop nuk mund të merrte nga vetja autoritetin që u rezervohet Sinodeve Ekumenike dhe Kishës në tërësinë e saj.

I zhytur pa dëshirën e tij në zemër të çështjeve të Kishës, në një periudhë të trazuar nga invazionet barbare, iu desh të shtrinte kujdesin e tij baritor në të gjitha fushat e jetës publike, duke i shfrytëzuar dhuntitë e tij si administrator në shërbim të drejtësisë dhe të frymës së Ungjillit. Veptoi si diplomat në çastin kur lombardët mbërritën në portat e Romës dhe kërcënuan se do të plaçkitnin qytetin; dhe ai, jo vetëm që arriti t’i pengonte, por arriti edhe armëpushim shpëtimtar. Madje, falë

mbështetjes së mbretëreshës së tyre, Theodelinda, e cila ishte orthodhokse, ai punoi me sukses për kthimin e tyre në besimin e vërtetë.

Duke ndrequr turbullirat e brendshme në Itali, u bë financier, që të shfrytëzonte burimet e Kishës, të blinte robërit dhe të bënte lëmoshë në dobi të Vendeve të Shenjta dhe të manastireve në mbarë botën e krishterë. I bindur se Kisha nuk mund të mbijetojë pa lutjet e murgjve, papa i shenjtë favorizoi ndërtimin e sa më shumë manastireve dhe drejtimin e tyre sipas traditave të Etërve të shenjtë, kryesisht të shën Benediktit të Norçias (14 mars), i cili ishte biografi dhe përhapësi i Kanonit të tij në mbarë Perëndimin.

I ndriçuar në mendje dhe realist për shenjat e kohëve, duke ruajtur marrëdhënie të mira me Konstandinopojën dhe me mikun e tij, perandor Mavrikun, shën Grigori i kushtoi vëmendje të madhe kthimit dhe edukimit moral të kombeve barbare, që kishin pushtuar pothuajse mbarë Evropën Perëndimore. Meqë nuk i hiqte nga mendja skllëvërit anglosaksonë, që i kishte parë në tregun e Romës, sapo mundi (596), dërgoi me mision në Angli dyzet murgj të drejtuar nga Shën Agustini (28 maj), igumen i manastirit të Shën Andreas dhe iu ofroi gjithë mbështetjen e tij këtyre apostujve të rinj. Kur mësoi për sukseset e para të hierapostullimit të tyre, shkroi me entuziazëm në gjithë perandorinë për të shpallur kthimin e një populli të ri.

Korrespondenca e gjerë që është ruajtur, dëshmon qartë për kujdesin e këtij bariu të mirë jo vetëm ndaj çështjeve të Kishës, por edhe për delen më të vogël shpirtërore. Sëmundjet dhe përkujdesjet e panumërta të detyrës nuk e penguan të vazhdonte veprimtarinë letrare. Gjatë viteve të tij në pontifikat përfundoi hartimin e Mësime për Jovin, komentari i zgjeruar i tekstit të shenjtë, në të cilin zhvillon një interpretim alegorik dhe moral, i cili do të pëlqej shumë gjatë Mesjetës. Me sens të hollë të meandreve të shpirtit njerëzor, ai paraqet në të aspektet e jetës së krishterë, që nga më praktikat, deri në perspektivat më të larta shpirtërore.

Shkroi gjithashtu edhe librin Mrekulli të Etërve të Italisë, më i njohur me emrin Dialogë, në të cilin tregon, në formën e bisedave me dhjakun e tij, Petron, luftërat asketike dhe mrekullitë e Etërve që jetuan në kohën e tij në zonat e afërta me Romën. Ngjarjet e mëdha shpirtërore, që i kishte grumbulluar për dobinë shpirtërore të murgjve të Shën Andreas, i përdori për të treguar se është i njëjti Shpirt i Shenjtë që vepron për të kryer mrekulli në kohën e tij, si dhe në atë të apostujve dhe si rrjedhim është e mundur në çdo kohë të arrihet bashkimi me Perëndinë. Çdo tregim e mbyll me një mësim doktrinal ose moral, sidomos në Librin IV, i cili i kushtohet jetës së shpirtave pas vdekjes dhe ndikimit të lutjeve të Kishës për prehjen e tyre.

Dhjaku Petro, sekretari dhe besniku i tij, thoshte se e kishte parë shpesh Shpirtin e Shenjtë të shfaqej në formën e një pëllumbi të bardhë, për t'i diktuar në vesh papës mësimet e tij qiellore. Edhe shën Grigori rrëfente se i ndodhte që nga brenda të dëgjonte Shpirtin e Shenjtë t'i diktonte interpretimet e Shkrimit të Shenjtë, të cilat nuk i kishte menduar kurrë.

Shën Grigori e kreu kështu misionin e tij për dyzet vjet, gjithmonë duke qarë për privimin nga përparësitë e jetës sositëse. Vuante shumë nga gjendja e çrregullt dhe prishja e moralit në Kishë pas invazioneve barbare, si dhe nga sëmundjet e tij, të cilat e sulmonin shumë, sa për dy vjet me zor u ngrit për Liturgjinë e të kremteve të mëdha. Prej Perëndisë kërkonte vetëm këtë ngushëllim: prehjen e përhershme. Dhe kjo iu dha më 12 mars të vitit 604. Duke u nisur për në banesën e shenjtorëve, la si trashëgimi shkrime dhe mësimet, të cilat i përgatitën Kishës një të ardhme të ndritur në Perëndimin barbar, i cili dalëngadalë u kthye në Krishtërim.